

III. Rinia dhe formimi teologjik-intelktual i Pjetër Bogdanit

1. Vëzhgime hyrëse

Në rast se shfletojmë prurjet e studiuësve të shumtë që janë marrë intensivisht me jetën dhe veprën e Imz. Pjetër Bogdanit, nuk do ta kemi aspak të vështirë me vënë re e përjetuar plotësimet në varg sidomos me atë material të pasur dokumentar-arkivor që i shtohet sipas kohës dhe rastit biografisë së tij,¹ parë kjo jo thjesht e vetëm si vijimësi e një karriere të suksesshme klerikale, me disa pika kulmore, si p.sh.: a) famullitar në zonën e Gashit; b) vikar në Kishën Metropolitane të Ohrit; e më pas c) ipeshkëv i Dioqezës së Shkodrës dhe d) arqipeshkëv i Arqipeshkvisë së Shkupit. Padyshim që nuk mungon të fokusohet në këto prurje edhe angazhimi e tij intelektual, si: “mâ i vleri ndër shkrimtarët e hershëm të shqipës” (Rrota 1941 46; Bartl 2007 267vv. etj.) sikurse ai social e deri politik, si udhëheqës shpirtëror e popullor në lëvizjen antiosmane të kohës (Zamputi 1954 39vv.; Malcolm 1998 142, 148vv.). Megjithatë nuk gabojmë aspak, në rast se mëtojmë qysh në fillim të këtyre vëzhgimeve hyrëse që, edhe pse këto shkrime plotësojnë, si të thuash, njëri-tjetrin në sendërtimin e një tërësie të përbashkët, feks në to gjithashtu – si anë e prapme e medaljes! – një zbrazëti e njëtrajtshme e po aq e përbashkët: Bëjmë fjalë këtu kryesisht për atë mangësi informacioni me karakter njohës-enciklopedik, sa i përket fëminisë e sidomos rinisë së tij si rishtar e student larg vendlindjes, bash aty ku Pjetri ynë përfitoi një formim klerikal e intelektual solid, duke përmbyllur me sukses studimet në teologji dhe filozofi e duke ngadhënjyer së fundmi gradën akademike *doctor* (= “mësues; me tagër mësimdhënieje”), atëbotë sa të rrallë aq edhe të lakmuar.

Asgjëmangut, po të duam ta relativizojmë tash këtë zbrazëti, duke pranuar opsionin e njëres prej zgjidhjeve të ndryshme alternative që janë përsiatur e hedhur në debat deri sot në historiografinë e kulturës së shkrimit shqip, lejohemi t'i kumtojmë lexuesit me stil telegrafik, ndër të tjera, se:

- Ende nuk kemi mundur të fiksojmë me siguri të paktën vitlindjen e tij, si: “pinjuell i familjes së përmendun të Bogdanvet, [qi] leu në katundin e Gurit të Hasit të Thát” (Rrota 1941 46) e për të cilin vjen ende në vështrim një hapësirë kohore ndërmjet moteve 1618 deri 1630; për më tepër:
- Botime të fundit të natyrës akademike-enciklopedike kanë nxitur

¹ MARLEKAJ (1989) 2008² 9vv.; MARQUET 1997 9vv. Shih edhe OSMANI 1996 13vv. (me referenca shtesë)

deri diku konfuzion lidhur me stacionet e formimit të tij klerikal e intelektual, duke mëtuar se: “Kreu studimet e larta teologjike e filozofike në Romë dhe mori titullin doktor.” (p.sh. FESH 2008² 271); e së fundi:

- Materiali dokumentar-arkivor që disponojmë është shumë i shpërndarë e për rrjedhje nuk është krehur e sistematizuar plotësisht, andaj e kemi ende të vështirë me fituar një përshtypje sado të përgjithshme ndaj mbarëvajtjes së formimit shkollor-teologjik e intelektual sikurse edhe mbarështimit social-edukativ, sa i përket mënyrës së sjelljes në rini të vet, bash në ato rrethe klerikale dhe shoqërore-intelektuale, të cilave u takonte. (Marlekaj 2008² 22)

Në këtë shkrim të shkurtër jemi përqendruar pikërisht në këto pak çështje që parashtruam më lart, përkatësisht në periudhën para fillimit të aktivitetit baritor të Imz. Pjetër Bogdanit në vendlindje, meqë pikërisht me këtë periudhë lidhen në një mënyrë a një tjetër jo vetëm “konfuzioni” i dokumentacionit arkivor ekzistues, por edhe ato pak të dhëna të reja dokumentare në formë grimcash biografike, që kemi mundur të qëmtojmë ndaj personit të tij gjatë kërkimeve tona të fundit në a) Archivio Storico della Sacra Casa (= ASSC – Loreto, maj 2015) si edhe në b) Archivio del Collegio Urbano dhe c) Archivio Storico di Propaganda Fide (= ACU / ASPF – Romë, shtator 2015), si tri stacione pune kërkimore në realizimin e projektit tonë afatgjatë që ka të bëjë me rindërtimin e rrjetit të formimit intelektual-fetar, përkatësisht të nivelit të diskursit intelektual-albanologjik në arealin kulturor shqiptar të Veriut përgjatë shek. XVII/XVIII deri në gjysmën e parë të shek. XIX.² Shtojmë së fundi se dy vatrave e para të dokumentimit arkivor (ASSC dhe ACU), pas gjase, nuk duket të jenë konsultuar më parë prej dy biografëve më të spikatur të Imz. Pjetër Bogdanit, të cilët s’mund të kenë tjetër emër përpos: Àt Jak Marlekaj (1989, 2008²) dhe Odette Marquet (1997), andaj edhe rezultatet e kërkimeve tona duan parë, sipas rastit, si plotësim dhe/ose verifikim i përsiatjeve, në shumësinë e vet më se solide, të arritura prej sosh.

2. Vitlindja e Imz. Pjetër Bogdanit: 1627

Si për shumë klerikë e intelektualë shqiptarë të kohës, (dita, muaji dhe) viti i lindjes janë dhe mbeten të mjegullta edhe për Imz. Pjetër Bogdanin.³ Prashtu shkruan Marlekaj (2008² 9) se:

“[...] dikush thotë të ket lé ndërmjet 1618^s e 1626^s; dikush

² Shih DEMIRAJ 2014.


³ Për problematikën e ditëlindjeve “zyrtare” tek autorët tanë të vjetër, shih së fundi DEMIRAJ 2006 35vv. ; 2013 27vv.

tjetër, me arsytetime mâ të vlefshme, e saktëson vjetin, tue mbajtë për të sigurtë 1625ⁿ; tjetërkush, mâ në fund, beson të ketë lé më 1630, por pa sjellë në mbrojtje të tezës së vet argumenta bindës.”⁴

E ky problem nuk gjen sigurisht zgjidhje as në kumtet dhe korrespondencën e vetë Bogdanit, të cilit Marlekaj (2008 10v.) me të drejtë nuk ia kursen aspak bodecin, meqë ky Bogdani ynë, sipas rastit (e pse jo, edhe nevojës), mëton mosha që s’përputhen aspak me të njëjtën vitlindje. Vetë Marlekaj (*po aty*), pas një argumentimi përjashtues-përzgjedhës të përsiatjeve të deriatëhershme, madje duke rrokur në to edhe kumtet plot dyshim të vetë Bogdanit në korrespondencën e tij, përcjell në debat një dokument zyrtar (në ASPF), në të cilin shkruhet shprehimisht se Bogdani paska pasë hyrë në vitin e 15-të të moshës së vet, kur qenka regjistruar ndërkohë, bash më 1642, në Kolegjin Urban të Propaganda Fide-s në Romë.⁵ Gjithsesi, disa mospërputhje të tjera në kohë, që kanë të bëjnë kryesisht me shmangie ndaj moshës atëbotë të detyrueshme për të marrë shugurimin priftëror, e nxisin edhe Marlekajn të ngushtojë me siguri relative radiusin e vitlindjes së Bogdanit ndërmjet moteve 1625 – 1627.⁶

Gjatë kërkimeve tona të fundit në ACU në regjistrin themelor të nxënësve në Kolegjin Urban ndeshëm një dëshmi të re dokumentare lidhur me emrin e Pjetër Bogdanit, i cili rezulton të jetë regjistruar në kolegji më dt. 13 shtator 1642, khs.:

Dëshmia (1)



Faksimile 1: Regjistrimi i Pjetër Bogdanit në kolegjin Urban: ACU CPF Registro vol. 1, f. 25.

<Pietro Bugdano Albanese entrò in Collegio a di 13 di \1642/ 7bre 1642. è di età d'anni 15 in circa.>

Shqip: "Pjetër Bogdani, shqiptar, hyri në kolegji më 13 shtator 1642; është në moshën rreth 15 vjeç."

Pa dashur të spekulojmë aspak me vërtetësinë e këtij kumti të moshës – pas gjase prej vetë Bogdanit ase ungjit të vet – (edhe ?) në këtë

⁴ Shih së fundi edhe BARTL 2007 273/shën. 25.

⁵ Kumt i kardinalit Giovanni Battista Pallotto lidhur me pranimin e Bogdanit në kolegji: „[...] Petro Bogdano Albanensi annum i5 agenti.“ (ASPF ACTA, vol. 15 [1642. 1643] fol 169)

⁶ MARLEKAJ (2008² 11) vë në pikëpyetje vitin 1627 si vitlindje të Bogdanit, meqë në vitin e pafiksuar bindshëm të shugurimit të tij (: 1650 ose 1651) sipas rregullit të përgjithshëm ai duhej të kishte mbushur moshën 25 vjeç. Për përjashtime nga ky rregull na mëson gjithsesi vetë MARLEKAJ (2008² 26/shën. 43).

regjistrim të parë,⁷ mendojmë se ky dokument e bën gjithsesi më se të besueshëm, të paktën pohimin e kardinalit Giovanni Battista Pallotto, të protokolluar një ditë më parë në sekretarinë e Propaganda Fide-s (shih shën. 5 dhe dëshminë nr. 2), duke na lejuar kështu të pranojmë qoftë edhe *ad hoc* vitin 1627 si vitlindje të Pjetër Tade Bogdanit nga Guri i Hasit (të Thatë) në zonën e Prizrenit.

3. Stacione të formimit teologjik-intelektual jashtë vendlindjes

Padyshim që ky regjistrim i parë në Kolegjin Urban të Propaganda Fide-s në Romë shënon vetëm njërin stacion në rrugëtimin motegjatë të formimit teologjik-intelektual të Imz. Pjetër Bogdanit. Këtij rrugëtimi i paraprin sigurisht – sikurse edhe e shoqëron gjithherë – përkujdesja e të ungjit, Imz. Ndre Bogdanit (= <Andrea Bogdani>), së fundmi arqipeshkëv i Kishës Metropolitane të Ohrit, me të cilin krijohet qysh në fëmëni një lidhje e ngushtë dhe e qëndrueshme shpirtërore e më pas edhe aktiviteti baritor. Hollësi të kësaj marrëdhënieje i mësojmë sidomos në punimin model të Marlekajt (2008² 9vv.; 16), sikurse edhe në mbledhjet e Marquet (1997 37vv.), të cilët nuk mungojnë assesit t'i përcjellin lexuesit një material të pasur dokumentar, të depozituar në ASPF.

3.1 Stacioni i parë (?): në kolegjin e murgjve françeskanë në Čiprovec (Bullgari)

Në letërsinë shkencore vjen e depërton së fundi mendimi se i ungji qenka përkujdesur që Pjetri ynë të hynte në moshë të njomë në kolegjin e murgjve françeskanë në Čiprovec (Bullgari). Për këtë fazë – edhe pse pa kurrfarë hollësish, sa i përket kohës dhe mënyrës së shkollimit – kumton edhe Marlekaj (1989, 2008² 16v.), i cili mëton të ketë konsultuar material arkivor shtesë, duke siguruar kështu argumente të tjera pozitive që tumirin atë konstatim deri diku të vagët, të bërë më parë. Veçse, siç sqaron me hollësi Bartl (2007 274), kemi të bëjmë në to thjesht e vetëm me një ngatërresë personash adashë me të njëjtin emër, pasi thujse në këtë kohë mësonte në kolegjin në fjalë ish-arqipeshkvi i Sofjes Petër Bogdan Bakšev.⁸

3.2 Në Kolegjin Urban të Propaganda Fide-s në Romë (1642 – 1647)

I ungji e shoqëron pas gjase në Romë në vitin 1642, ku i bëhet vend në Kolegjin Urban të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s, duke iu siguruar një mbështetje financiare mujore prej gjashtë skudash,

⁷ Shih shën. 4.

⁸ Një adash të dytë: <Pietro Bogdano da Siam[?]inza in Dalamtia> e lexojmë të jetë regjistruar më 8 qershor 1660 në Kolegjin Urban (ACU CPF Registro vol. 1, f. 87).

ndër të cilat katër ia mundësonte fondi përkatës i Kongregacionit dhe dy të tjera fondi Sant' Onofrio i kardinalit Barberini,⁹ me të cilin financoheshin atëbotë vetëm nxënës të kolegjit që vinin nga vendet e Orientit.¹⁰ Këtë detaj e mësojmë së pari prej Marlekajt (2008² 18), biografit sqimatar të Bogdanit, i cili përcjell në debatin albanologjik dokumentin pas gjase më të hershëm arkivor në ASPF, khs.:

Dëshmia (2):

“Më 12 shtatuer 1642. Tue i parashtue shumë i Hirshmi Zoti Kardinal Pallotto Kongregacionit Shëjt Pjetër Bogdanin, shqiptar, në të 15-at, dekretoi katër skuda në muej, në mënyrë që me dy skudat e tjerë në muej, caktue atij prej shumë të Hirshmit Zotit Kardinal Sant'Onofrio, të mundet me u pranue në Kolegjin e Propaganda Fide-s e në ketë si nxanës, të mësohet në zakone të mira dhe shkenca e, shi mbas betimit që do t'u jepet prej tij për me kthye mandej, në përputhje me betimin që ka me bâ n'atdhë të vet për me u shërbye bashkëkombësve në punët shpirtnore.” (përkthyer prej Willy Kamsit)¹¹

Është pikërisht kjo dëshmi vendimmarrëse prej instancës përkatëse në Kongregacionin e Shenjtë të Propaganda Fide-s¹² që i prin sipas rastit, qoftë: a) regjistrimit të bërë një ditë më pas në kolegji (shih §2/dëshmia nr. 1); ashtu edhe b) listës së nxënësve të Kolegjit Urban


⁹ Shih MARLEKAJ (2008² 18 / shën. 23, 24) me pasazhe të dokumentacionit përkatës: ASPF ACTA vol. 15 [1642, 1643] fol. 169r.

¹⁰ JEZERNIK 1971 465vv.

¹¹ ASPF Acta vol. 15 [1642, 1643] fol. 169r: (teksti origjina) <Die i2 7bris i642. Referente Eminentissimo Domino Cardinali Palloto Sacra Congregatio Petro Bogdano Albanensi annum i5 agenti scuta quatuor menstrual decrevit ut cum alijs duobus scutis mensuris illi ab Eminentissimo Domino Cardinali Sancti Honuphrij assignatis possit in Collegio de Propagande Fide collocari, ibique ut Alumnus instrui in bonis moribus, et scientijs, ac iuxta iuramentum ab eo praestandum in patriam suam reverti ad inserviendum in spiritualibus suis concivibus.> MARLEKAJ (*loc. cit.*) shton edhe një variante (pas gjase protokollim) të kësaj dëshmie me shmangie minimale në italisht, khs.: “Relatore l'Eminentissimo Signor Cardinale Palloto, la Sacra Congregazione ha decretato a Pietro Bogdano Albanese, il quale è entrato nel quindicesimo anno di età, quattro scudi mensili, perche con altri due scudi mensili assegnatigli dall'Eminentissimo Signor Cardinale di Sant'Onofrio, possa essere ammesso al Collegio di Propaganda Fide, e, ivi, comme alunno, essere istruito nei buoni costumi e nelle scienze, per ritornare poi, in conformità del giuramento che egli deve prestare, nella sua patria a servire i suoi connazionali nelle cose spirituali.”

¹² Hollësisht për këtë MARLEKAJ (2008² 17), që vë në dyshim deponimin e Àt Gjon Bogdanit, nip i Imz. Pjetër Bogdanit (ASPF SOGG, vol. 506, fol. 251r-252r; shih edhe MARQUET 1997 508vv.), i cili mëton që axha i vet të jetë regjistruar më parë në Kolegjin Ilirik të Loreto-s e prej andej të jetë transferuar më pas në Kolegjin Urban në Romë. Kërkimet tona në regjistrat e nxënësve të Kolegjit Ilirik në Loreto (ASSC) nuk mundën të verifikojnë dot këtë hamendje, edhe pse regjistrimi për periudhën në fjalë duket të jetë i patëmetë. (shih § 3.3)

në vitin 1642 (dëshmia nr. 3), për të cilën kumtojnë të dy biografët e Bogdanit: Marlekaj (1987; 2008² 19/fs. 27) dhe Marquet (1997 29), khs.: Dëshmia (3)



Faksimile 2: ASPF SC Collegio Urbano (1622-1677), vol 1 fol. 61r.¹³

¹³ MARQUET 1997 29: rreshti <14. Pietro Bugdano. Albanese. Studente di Grammatica>.

Përpos kësaj liste, në dosjet e shumta në ASPF hëpërhë nuk mësojmë dot diçka më shumë lidhur me jetën dhe mbarëvajtjen e studimit të Pjetër Bogdanit në Kolegjin Urban. Kontaktin me të e kish humbur me sa duket vetë i ungji, i cili plot pesë vjet më vonë (prill dhe nëntor 1647) i drejtohet dy herë radhazi e me preokupimin e rastit Propagandës, meqë s'kishte marrë ende kurrfarë informacioni për të nipin "as për mirë e as për keq".¹⁴ Dhe përgjigjja ndaj insistimit të tij të përsëritur erdhi, anipse nuk do të ishte assesi ngazëlluese, meqë Bogdani ynë atëbotë nuk ndodhej më në atë kolegji, përkatësisht kishte kërkuar të largohej vullnetarisht prej tij. Për këtë kumt të ri, sa të sigurt aq edhe shqetësues i detyrohemi rishtas Marlekajt (2008² 22), i cili na përcjell në studimin e vet edhe notën e arkivuar të sekretarit të Propagandës: Dëshmia (4):

"Të njoftohet e t'i jepet llogarí se nipi i tij nuk gjindet mâ në Kolegji tue pasë lypë (*fjalët që ndjekun kanë qenë shlye*: për mosmarrëveshje të ndryshme të pasuna me Rektorin) me dalë prej Kolegjit." (përkthyer prej W. Kamsit)¹⁵

Shkakun dhe natyrën e këtyre mosmarrëveshjeve vështirë ta mësojmë me hollësi dikur, meqë për to dëshiron të heshtë edhe sekretari i Kongregacionit të Shenjtë dora vetë. E janë me sa duket bash këto rrethana që e nxisin Marlekajn (2008² 23) të mos hezitojë të marrë në mbrojtje Pjetrin, patriotin e vet den-baba-den, duke mëtuar: "të ketë qenë një vlerësim i gabuem i natyrës shumë të gjallë të të riut nga ana e eprorit të vet: pra duhet të ketë qenë fryma e mos të marrunit vesh që kishte rrjedhë, e cila e shtyni djaloshin me lypë leje për me e lanë ambientin romak." Pa dashur të mbajmë aspak anën e kujt në gjithë këtë mesele, mendojmë se kemi të bëjmë me një rast të pazakonshëm, një lloj "rebelimi individual", në kohën dhe për kohën kur ndodhi, bash në një institucion të mirënjohur edhe sot e kësaj dite, sa i përket sjelljes dhe respektimit, përkatësisht mënyrës së komportimit të individit në varësi me pozicionin e tij në hierarkinë organizative brenda atij institucioni.

Prashtu kjo "kryeneçësi" e Bogdanit për t'i lënë fare pendlat e korbit atij kolegji na lejon të përsiasim me më shumë siguri edhe një tipar, pas gjase të zakonshëm (?), të karakterit të tij si djalosh çamarrok e

¹⁴ Hollësisht MARLEKAI 2008² 21/fš. 31: (letër e dt. 27 prill 1746): "[...] ne pure mio Nipote Pietro mi ha scritto, non so di lui ne bene ne male [...] Se ha di bisogno il mio Nipote Vostra Signoria Illustrissima li dia della mia pensione che non patischi lui ankora più che io.[...]" (ASPF SOCG, vol 178 fol. 282r/v)

¹⁵ ASPF SOCG vol 178, fol. 285v: (teksti origjinal) <S'avvisi e si li dia conto che suo nipote non è più nel Collegio havendo domandato licentia per vari disguidi havuti col Rettore d'uscir dal Collegio.>

paksa i sertë që hedh shqelma ku dhe si të mundë; veçse është më se i ndërgjegjshëm si për aftësitë dhe nivelin e lartë të intelektit, bashkuar ky me vullnetin e veçantë për të studiuar, ashtu edhe si një i ri pa kurrfarë kompleksi inferioriteti në sjellje e komportim brendapërbrenda asaj hierarkie organizative që funksiononte të paktën në kolegji.

Veprime të kësaj natyre sigurisht që atëbotë nuk i anashkalonin lehtë ndëshkimit, madje ndër më të rëndit. Por, ja që fati e solli – si rast i dytë, po i pazakonshëm (?) – që largimi i Pjetër Bogdanit nga Kolegji Urban nuk shoqërohet aspak me ndonjë ndëshkim të rëndomtë të kohës, përderisa shpejt do ta ndeshim në Kolegjin Ilirik të Loretos, i cili ishte poashtu në varësi, qoftë edhe të ndërmjetme, administrative ndaj Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s.

3.3. Në Kolegjin Ilirik të Loreto-s (1648-1649)

A kemi të bëjmë thjesht dhe vetëm me një transferim nga një kolegji në tjetrin, që vjen me thënë me një masë të zbutur administrative, kur mbyllet një sy e zihet një vesh, thjesht dhe vetëm për të ulur gjakrat ndërmjet dy palëve që u përkisnin pozicioneve krejt të ndryshme në hierarkinë e klerit aktual? Kësaj pyetjeje Marlekaj nuk i jep dot përgjigje, meqë edhe materiali dokumentar-arkivor që kemi në dispozicion është i mangët. Fakt është gjithsesi, që Bogdanit iu bë vend në Kolegjin Ilirik të Loreto-s në një kohë kur aty sapo kishte përfunduar studimet <Christophor Cucumarich> nga Montenovio (= <Novobrd>) me vend burse të Arqipeshkëvisë së Shkupit, përkatësisht pasi kishin rënë me sa duket më parë në ujdin institucioni i Propagandës nëpërmjet kardinal Pallotto-s – si dorëzanës i dikurshëm i Bogdanit (shih § 2) – dhe arqipeshkëvit të porsaemëruar të Kishës Metropolitane të Ohrit, Imz. Levakoviç-it (= <Raphael Leuacouich> – vitet 1647-1649). Këto rrethana disi të ndërlikura i saktëson më së miri ekstrakti i mëposhtëm prej një regjistri të depozituar në ASSC në Loreto, të cilin patëm fatin ta shfletonim e hulumtonim së fundi (mars 2015), khs.:

Dëshmia (5):

“Pjetër Bogdani nga Prizreni, i dërguar në Kolegjin Ilirik [të Loreto-s – B.D.] prej bashkëdorëzanësit, Eminencës z. Kardinal Pallotto dhe i shoqëruar prej Imz. Arqipeshkëvit të Ohrit më 20 mars 1648 në vendin e Christofaro Chocomerich prej Montenuovo-s [= *Novobrd* – B.D.] në Serbi. U hezitua, nëse mund ta zinte vendin në fjalë dhe u shkrua në adresë të Eminencës në fjalë e [që] përgjigjet kështu: Para se të merrej në konsideratë Kisha [Metropolitane – B.D.] e Ohrit, emërimi i [vendit të studimit për Arqipeshkëvinë e – B.D.] Shkupit

dhe Prizrenit – që janë në Provincën [administrative kishtare – B.D.] të Ohrit, në të cilën bëjnë pjesë *Mysia Superior* dhe *Macedonia Secunda* – i takonte Arqipeshkvi të Tivarit edhe [si] Primat i Serbisë. Por tani kjo [Kishë – B.D.] Metropolitane e ka bariun e vet dhe ka të drejtën për vende [studimi në kolegji – B.D.], që janë subjekte të juridiksionit të saj, andaj duhet të justifikohet emërimi i bërë për të përmendurin Pjetër Bogdani. Hezitimi ishte që Prizrenit, atdheut të Pjetrit në fjalë, duhej t'i hapej një vend, kur Shtëpia e Shenjtë [në Loreto – B.D.] të mund të trajtonte me ushqim tetë subjekte të tjerë, të cilët [faktikisht] nuk i ushqen. [Bogdani – B.D.] ka sjellë kopjen e emërimit të Imz. të Ohrit [= <Raphael Leuacouich> – B.D.], e cila është depozituar në arkiv bashkë me letrën e bashkëdorëzanësit, Eminencës z. Kardinal Pallotto. [Bogdani – B.D.] u nis për në atdhe, i kthyer nga Roma, ku u doktorua në Kolegjin [Urban – B.D.] të Propagandës me shumë përndërim të tij. U soll gjithëherë në mënyrë të përkryer; them se u nis më 17 maj 1651. Arqipeshkvi i Shkupit.”¹⁶

Kjo dëshmi arkivore e rëndësishme na mëson – përpos asaj që përmendëm dy paragrafë më lart – ndër të tjera, se:

- a) Bogdani regjistrohet në Kolegjin Ilirik të Loreto-s më datë 20 mars 1648.¹⁷

¹⁶ ASSC Antichi Regimi tit. 30-32 fol. 10v, 14v. (teksti origjinal): <PIETRO BOGDANO da Prisien, mandato dall'Em.^{mo} Sig.^r Card. Pallotto Comprotettore e condotto in Coll.^o Illirico da Monsig. r Arciu.^o d'Ocrida li 20 di Marzo 1648 in luogo di CHRISTOFARO COCOMERICH da Montenuuo in Seruia, s'è dubitato se poteua occupare il d.^o luogo e se ne scrisse a d.^o Em.^{mo} e risponde così: Prima che restasse prouista la Chiesa d'Ocrida, toccaua la nominatione d'Euscopia (!), et di Prisien che sono nella Prouincia d'Ocrida, in cui sono la Misia superiore, e la seconda Macedonia, all'Arciuescouo d'Antiuari e Primato di Seruia. Hora però che questa Metropolitana hà il suo Pastore, hà le ragioni de luoghi, che sono soggetti alla sua giurisditione, onde deue hauere effetto la nominatione fatta di d.^o PIETRO BOGDANI. Il dubio era che Prisien patria del d.^o PIETRO nella Bolla deue hauer luogo quando la S. Casa possi alimentare otto altri soggetti, che non gli alimenta. Ha portato la copia della nominatione di Monsig.^r d'Ocrida, è posta nell'Archiuio con la lettera dell'Em.^{mo} Sig.^r Card. Pallotto Comprotettore. Partì per la Patria tornato da Roma oue s'adotterò al Coll.^o de prop. con molto suo honore. Si portò sempre ottimamente, partì dico li 17. Maggio 1651. Arciu.^o Uscopia.>. Shih edhe JURIC – KORADE 1982 89.

¹⁷ MARLEKAJ (2008² 23/fs. 35) mëton që: ”Shpërngulja [...] duhet të ketë ndodhë prâ më 1647.”, por pa sjellë ndonjë provë dëshmuese për këtë. MARQUET (1997 35) citon në të kundërtën një letër (pa faksimile) të Bogdanit nga Loreto, datuar më 29 mars 1648, dhe në fund me shënimin e sekretarit të Kongregacionit ”Loreto 28 marzo 1648 / Pietro Bogdani / che è ricevuto in quel Collegio etc. / A die 4 Aprilis 1648”. Datën 20 mars 1648 e tumirin gjithashtu JURIC – KORADE (*loc. cit.*) Mungesa e dokumentacionit arkivor e bën gjithashtu të vështirë hetimin e jetës dhe veprimtarisë së Bogdanit gjatë periudhës midis largimit nga Kolegji Urban (1647) dhe hyrjes në Kolegjin Ilirik të Loretos (20.03.1648).

- b) Për pranimin e tij në kolegji ishin shprehur fillimisht rezervat e rastit prej bordit drejtues të kolegjit, përkatësisht rektorit të tij Giacomo Micaglia SJ.¹⁸
- c) Bogdani u nis për në atdhe, përkatësisht për në Arqipeshkvinë e Shkupit (zona e Gashit) prej Romës më dt. 17 maj 1651.
- d) Në Romë ai doktoroi me shumë sukses në Kolegjin (Urban) të Propagandës; dhe së fundi:
- e) Gjatë gjithë kohës së qëndrimit në Loreto u dallua për sjellje shembullore.

Ndër të dhënat plotësuese që përcjell kjo dëshmi e re të bie në sy sidomos shënimi i bërë në fund për sjelljen e patëmetë të Bogdanit në Kolegjin Ilirik të Loreto-s, sikurse edhe fakti që para largimit për në atdhe më 17 maj 1751, ai u rikthye në Romë në Kolegjin Urban, ku doktoroi më sukses. E këto regjistrime nuk mund t'i kuptojmë ndryshe, veçse si „rehabilitim i plotë” dhe i mirëseardhur i personit në fjalë nga ana e institucionit të Propaganda Fide-s, në mos edhe e Kolegjit Urban që varej prej tij.

Sa kohë ndenji Bogdani në Kolegjin Ilirik të Loreto-s, ç'farë angazhimi pati, përkatësisht ç'farë studimesh përmbylli dhe a doktoroi ai në këtë kolegji? Kemi të bëjmë këtu me një qerthull pyetjesh, që pas gjase nuk janë ezauruar sa dhe siç duhet në historiografinë e kulturës së shkrimit shqip. Vështirësi kanë hasur në këtë rast si Marlekaj ashtu edhe Marquet, të cilët i kanë përqendruar hulumtimet arkivore vetëm në Romë. Megjithatë interes paraqesin në këtë drejtim sidomos dy letra të Bogdanit drejtuar Kongregatës më (pa datë) 1647 dhe më 19 shkurt 1648,¹⁹ ku, përpos premtimit për sjellje të mirë, ai insiston në dëshirën për të vijuar studimet në fushën e moralit dhe të fitojë pak përvojë edhe në mjekësi. Sipas tij, vijimin e studimeve – sigurisht vetëm falë mbështetjes bamirëse të Kongregacionit të Shenjtë – e kushtëzonte në një mënyrë a një tjetër edhe rrethana që ai nuk e kishte mbushur ende moshën për t'u shuguruar prift.²⁰

¹⁸ Shih MARLEKAJ 2008² 24v.

¹⁹ MARQUET 1997 31vv.

²⁰ Khs. p.sh. letrën e dytë në ASPF SC Visite e Collegi 1648, vol. 29, fol. 51r: <[...] Pietro Bogdano Alunno del Collegio di Propaganda [= Urbano – B.D.], alimentato dalla Sacra Congregazione per spatio di sei anni, hora mentre sta per germogliare fiori e frutti delle sue long(h)e fatiche, supplica l'Eminenza Vostra che non bastando all'Oratore il spatio d'un mese, si per non haver alcuna cognizione nella morale studio utilissimo ad un Parocho, si ancora per non haver gl'anni sufficienti per l'ordini, si compiaccia l'Eminenza Vostra nella quale sta rimesso et appoggiato il negotio, di prorogare al sudetto la provisione essendoli già spirata all'ultimo del passato ne havendo più con che mantenersi, solo si ricorre sotto le ali pietose della sua clemenza, che sia con ochio pietoso da questa rimirato. [...]> (Vëzhguar prej MARQUET 1997 33, dhe f. 34-5 me letrën e tij falënderuese [29 mars 1648 prej Kolegjit të

Në rast se i anashkalojmë tash edhe një letre falënderimi dhe mirënjohjeje, me të cilën Bogdani i drejtohet dorëzanësit të vet, kardinal Pallotto-s më 29 mars 1648 (shih shën. 19), një shenjë tjetër “zyrtare” kjo e jetës së tij në Kolegjin e Loretos, Bogdanin e ndeshim aty rreth nëntë muaj më vonë në kopjen e regjistrit të emrave të nxënësve në kolegji, i cili dërgohej çdo fillim viti në Kongregacionin e Shenjtë të Propaganda Fide-s, khs.:

Dëshmia (6):

<Copia del Catal. mandato a Roma quest’anno 1649 di Gen.

[....]

Petrus Bogdanus Priserens. 21, Albanense, Uscopiens. An __
mesi 9.

[...]>²¹

Shqip: “Kopje e regjistrit dërguar në Romë këtë vit, janar 1649 | Pjetër Bogdani, nga Prizreni, 21 (vjeç), shqiptar, (me bursën e caktuar për) Arqipeshkinë e Shkupit, në vitin __ / muajin e nëntë (të studimit).”²²

3.3.1. Anëtarësimi në Urdhërin Jezuit: një përpjekje e dështuar

Një letër tjetër e Bogdanit – e qëmtuar së fundi prej nesh – e hartuar në formën e një lutjeje-kërkesë dhe dërguar pas gjase po në vitin 1649 prej Kolegjin Ilirik të Loreto-s, na dëshmon do rrethana të reja, në cilat jetonte ky nxënës paksa i sertë e gjithërë kërkues ndaj vetvetes dhe të tjerëve! Le të ndjekim tani nga afër përmbajtjen e kësaj kërkesë në formë lutjeje:

Dëshmia (7):

„ [.....] Pjetër Bogdani i frymëzuar prej Shpirtit të Shenjtë për t’u bërë klerik i Kompanisë së Jesus-it i lutet me shumë devocion Eminencës Suaj për t’i kërkuar Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s hirin dhe bekimin, tash që Patër Provinciali i Kompanisë e kërkon për ta pranuar: Sepse, nëse lutësi [i kërkesës] e ka kryer dikur betimin, sikurse nxënësit e tjerë në të njëjtin kolegji, ky [= betim] aktual e detyron: edhe pse duke qenë në [fazën] më të frytshme të studimeve të veta, kur studionte fizikë [= mjekësi ?], iu pre ushqimi [= bursa e ushqimit], për çka nxënësit janë të privuar [duke iu

Loreto-s] për marrjen në konsideratë të lutjes së tij nga ana e Kongregacionit të Propagandës)

²¹ ASSC Antichi Regimi – tit. XXX: Miscellanea; C) Copia dei Cataloghi mandati a Roma, fol. 114r.

²² Janari 1649 si muaji i nëntë i studimit në kolegji, përkon katërcipërisht me muajin e regjistrimit të tij në mars 1648.

nënshtuar] betimit, dhe duke ndodhur, ashtu siç i ndodhi e po i ndodh [tash] lutësit, e sidomos që Kongregacioni i Shenjtë u ndërpret atyre resurset e nevojshme për përfundimin e studimeve të tyre; [sepse] në këtë rast ujdia e rënë me nxënësit, d.m.th., që ata sapo të kenë mbaruar studimet e tyre të shkojnë në atdhe të vet për të mbarështuar besimtarët, bëhet e pavlefshme, e për rrjedhojë betimi nuk mbetet [më] i detyrueshëm: përndryshe lutësi i drejtohet rishtas Eminencës Suaj për hirin [tuaj] kooperativ ndaj Vokacionit të tij të shenjtë. [...]"²³

Siç mësojmë edhe nga përmbajtja e kësaj lutjeje në formën e një kërkesë me shkrim, Bogdani kishte provuar me guximin e tij të zakonshëm, pra me kokë të vet, së pari t'i bashkohej Urdhrit Jezuit e me këtë rrugë, pra së dyti, të shtonte e të plotësonte formimin e tij intelektual-akademik në lëndë e fusha që tingëllonin krejt të pazakonshme për programin mësimor të zakonshëm në Kolegjin Ilirik të Loretos, siç ishin p.sh. fizika apo mjekësia. Duke u rrekur tash me lexuar midis rreshtash, mësojmë shumë më shumë, sa u përket edhe statusit e të drejtave që kishin atëbotë nxënësit e kolegjeve ilirike në Loreto e Fermo, sikurse edhe ata nxënës ilirikë në Kolegjin Urban në Romë. E Pjetri ynë ishte njëri syresh, anipse me kapacitet intelektual të pazakonshëm. Si tillë ai ishte regjistruar në Romë (shih më lart), e pasi kishte kaluar me sukses disa muaj në bankoprovë, ishte pranuar përfundimisht në kolegji (fillimisht në Romë e transferuar më vonë në Loreto), duke bërë edhe betimin përkatës. Bëjmë fjalë për betimin meshtarak të shkallës së parë, të diktuar atëbotë nga Kongregacioni i Propaganda Fide-s, e sipas të cilit çdo nxënës ilirik që do ta kryente atë betim, ishte i detyruar, ndër të tjera:

- a) të bënte jetë të rregullt të nxënësit të kolegjit, duke qenë gjithmonë në dispozicion të Kongregacionit, pra duke mos tentuar në asnjë

²³ ASPF SOCG 361: Collego de Prop. Fide. – Alumni f. 147 [Mem. 1649]: (teksti origjinal: <Emtis.o et Re.mo Sig. et Pri Colmo, | Pietro Bogdano inspirato dallo Spirito Santo á farsi Religioso della Comp[agnia]a di Gesù, supplica deuotis[sim]o l'Em[inen]za V[ost]ra ad intercederli dalla Sacra Cong[regation]e de Propaganda Fide la gratia, et la beneditione, già ch'il P[ad]re Prou[incia]le della Comp[agnia]a la ricerca p[er] riceuerlo : Che se l'O[rato]re, ha fatto il giuramento come gl'altri Alunni nell' istesso Coll[egi]o quello di presenti ne obliga, essendoche nel più bello de' suoi studij, q[uan]do studiaua la Physica li sono stati leuati gl'alimenti p[er] li quali gl'Alunni sono obligati al giuram[en]to, et occorrendo com' é occorso all'O[rato]re, che la Sacra Cong[regatio]ne leua loro le prouisioni necessarie p[er] l'co[m]pimento de loro studij, in tal Caso il Contratto fattosi dagl'Alunni, cioè, che finiti li loro studij andauano nelle loro Patrie per aiuto dell'anime, resta rescisso, et consequentem[en]te il giuram[en]to non remane obligatorio: onde l'O[rato]re supplica di nuouo V[ost]ra E[mine]nza della gratia cooperatoria á questa sua santa Vocatione: Che del tutto p.>

rast – pa lejen eksplicite të Kongregacionit – të krijonte kontakte personale jashtë kolegjit e aq më pak të bëhej pjesëtar i urdhrave të tjerë fetarë, ase t'i bashkohej klerit dioqezan të rrethinave apo të hynte në oborret e familjeve fisnike (Ancona, Reccanati, Loreto etj.)

